



Pranuar / Dorezuar Priljena / Predato Received / Delivory	31.05	2021	1	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHICK	2757/2021		116	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.262/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2224/19 të datës 31.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.410/2019 të datës 18.07.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga “Egratia”, Nr.13, banesa 21 në Ulpianë-Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.Prot:6528 të datës 18.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.410/2019 e datës 18.07.2019 e parashtruar nga ankuesi**
- II. SHFUQIZOHET** Vendimi me Nr.Prot:6528 i datës 18.06.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit dhe Vendimi me Nr. Prot:4440 i datës 26.04.2019 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.
- III. OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimin të tij, duke e kthyer ankuesin në pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe Përgatitjen e Testeve për Patent Shoferë” sipas Akt Emërimit 23.08.2018 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit duke u bazuar në autorizimin e Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 25.06.2018, me datë 27.06.2018 ka shpallur konkursin për avancim për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe Përgatitjen e Testeve për Patent Shoferë”, ku janë paraparë kriteret si: **“Diplomë Universitare: Fakultetit Juridik, ekonomik dhe fakulteti i komunikacionit, pesë (5) vite përvojë pune profesionale”.**

Në këtë konkurs kanë aplikuar tre (3) kandidatë të punësuar në ministri si:

dhe Ushtruesi i Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës më datë 09.07.2018 ka nxjerr Vendim me Nr. Prot:6507 me të cilin ka bërë emërimin e komisioni përzgjedhës ndërsa më datë 13.07.2018 Ushtruesi i Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës ka nxjerr Vendim me Nr. Prot:6705 me të cilin ka bërë ndryshimin e një anëtari të Komisionit Përzgjedhës pasi që një anëtar ka pasur rast të vdekjes. Komisioni Përzgjedhës ka përgatitur listën e shkurtër prej tre (3) kandidatëve. Pas përfundimit të gjithë procedurës së rekrutimit Ministria e Infrastrukturës më datë 23.07.2019 ka publikuar njoftimin për kandidatin e suksesshëm ku ankuesi ka marr 896 pikë.

Ministria e Infrastrukturës duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 07/2010 për Emërimin e Nëpunësve Civilë, më datë 23.08.2018 ankuesit i ka lëshuar Akt Emërimin.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit më datë 26.04.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. Prot:4440 me të cilin ka anuluar të gjitha veprimet që rrjedhin nga konkursin për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe Përgatitjen e Testeve për Patent Shoferë" duke anuluar Akt Emërimin e datës 23.08.2018 dhe duke e kthyer ankuesin në pozitën "Koordinator për Drejtat e Njeriut, duke konstatuar që përgatitja profesionale e ankuesit nuk përputhet me përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e lartcekur.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. Prot:4440 të datës 26.04.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, më datë 20.05.2019 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:5330 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit më datë 18.06.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. Prot: 6528 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit duke lënë në fuqi Vendimin me Nr. Prot:4440 e datës 26.04.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. Prot: 6528 të datës 18.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.07.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3211/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.07.2019, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit. Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit më datë 05.08.2019 ka përcjell në Këshilli përgjigjen në ankesë së bashku me dokumentacionin e kërkuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 22.08.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 31.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2224/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 22.08.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 18.07.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova:
Ankesën me numër protokolli 3211/2019 të datës 18.07.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.Prot: 6528 të datës 18.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit; Ankesën me Nr.Prot:5330 të datës 20.05.2019 të parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës; Vendimin me Nr. Prot:4440 të datës 26.04.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit; Autorizimin e Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 25.06.2018; Konkursin për avancim i datës 27.06.2018 i shpallur nga Ministria e Infrastrukturës për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe Përgatitjen e Testeve për Patent Shoferë”; Formularin MAP-SHCK-07a për përcaktimin e kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punë për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Formularin MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kriterëve për përfshirje në listën e ngushtë i datës 13.07.2018; Formularin MAP-SHCK-04 për regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Formularin për krijimin e listës së shkurtër; Formularin MAP-SHCK-11 për raportin final i rekomandimi nga Komisioni Rekrutues i datës 19.07.2018; Njoftimi i kandidatëve për testim nga përzgjedhja e ngushtë; E-mailin e datës 13.07.2018, 17.07.2018 dhe 23.07.2018 nga ankuesin; Testin me shkrim të datës 16.07.2018 të ankuesit; Njoftimi i kandidatëve mbi përzgjedhjen e kandidatit; Formularët MAP-SHC-08a për vlerësimin individual të kandidatëve për vendin e punë për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Raporti i komisionit përzgjedhës për krijimin e listës së ngushtë dhe intervistimit të kandidatëve i datës 20.07.2018; Formulari MAP-SHCK-10 për renditjen përfundimtare të kandidatëve; Njoftimi për kandidatin e suksesshëm i datës 23.07.2018; Aprovimi mbi përzgjedhjen e kandidatit; Akt Emërimin e datës 23.08.2018 dhe 17.01.2012 i ankuesit; Diplomën me Nr. 2359 të datës 20.04.2010 të ankuesit; Kontratën e punës e datës 24.02.2011, 10.07.2003 të ankuesit; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin i datës 21.12.2017, 15.01.2016, 15.12.2016; Vendimin me Nr. Prot:761 i datës 26.01.2018; Vendimin me Nr. Prot:597 i datës 10.02.2016; Vendimin me Nr. 3654/2015 i datës 04.05.2015; Konkursin e datës 03.05.2019 për Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit të Auto shkollave; Deklaratë e datës 12.07.2018; Vendimin me Nr. Prot:6507 i datës 09.07.2018 për emërimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës; Vendimin me Nr. Prot:6705 i datës 13.07.2018 për emërimin e anëtarit të komisionit përzgjedhës; Kërkesën për punësim e datës 04.07.2018 e ankuesit; Certifikatat e ankuesit; Vërtetimin e marrëdhënies së punës për ankuesin; Kërkesën për punësim të kandidatit e datës 02.07.2018; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për kandidatit i datës 20.12.2017, 23.12.2016; Akt Emërimin e datës 17.05.2012 i kandidatit Kontratën e punës për kandidatin i datës 20.10.2009, 09.07.2001; Vendimin me Nr. Prot:8734 i datës 16.11.2017; Certifikatën e datës 17.07.2010 të lëshuar nga Kolegji Universitar “BIZNESI” për kandidatin Certifikatën e datës 28.06.2018; Vërtetimin e marrëdhënies së punës për kandidatin Rekomandimet; Kërkesën për punësim e datës 04.07.2018 e kandidatit Certifikatën e datës 28.06.2018; Rekomandimet; Diplomën me Nr. 205/09 e datës 10.07.2009 e kandidatit Rekomandimin e datës 09.01.2014 nga Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës për Certifikatat e kandidatit Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës për kandidatit i datës 15.12.016, 26.12.2017; Vërtetimin e marrëdhënies së punës për kandidatit Akt Emërimin e datës 29.04.2015 për Pasqyren e llogarisë nga TRUSTI për Formularin për përshkrimin e detyrave të punës i datës 18.06.2018 për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe Përgatitjen e Testeve për



Patent Shoferë” dhe Përgjigjen në ankesë e datës 05.08.2019; Aktgjykimin A.nr.2224/19 të datës 31.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Njoflimin e datës 22.08.2019 për ankuesin.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që: Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës me rastin e anulimit të konkursit të datës 27.06.2018 ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të shërbimit civil po ashtu edhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e nxjerrjes së vendimit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës me rastin e anulimit të konkursit të datës 27.06.2018 ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të shërbimit civil, ka konstatuar që Ministria e Infrastrukturës duke u bazuar në Formularin e përkrahimit të detyrave të punës për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe Përgatitjen e Testeve për Patent Shoferë”, ka parashtruar kërkesë tek Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike për lejimin e shpallje së konkursit për këtë pozitë të cilën kërkesë e ka miratuar Udhëheqësi më i Lartë Administrativ i Ministrisë së Infrastrukturës dhe pastaj më datë 25.06.2018 është aprovuar edhe nga Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike ku janë përcaktuar edhe kriteret mbi bazë të cilave është miratuar kërkesa si: **“Diplomë Universitare: Fakultetit Juridik, ekonomik dhe fakulteti i komunikacionit, pesë (5) vite përvojë pune profesionale”**, në këtë kuptim Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të shqyrtimit të provave të lëndës, konstaton që kriteret për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe Përgatitjen e Testeve për Patent Shoferë” të cilat janë miratuar edhe nga Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike janë përcaktuar në Formularin e përkrahimit të detyrave të punës të datës 18.06.2018 dhe nuk ka ndonjë akt tjetër se këto kriteret janë të ndryshme nga ato që janë miratuar, si rrjedhojë Ministria e Infrastrukturës respektivisht Menaxheri i Njësisë së Personalit dhe Udhëheqësi më i Lartë Administrativ kanë vepruar në pajtim me nenin 10 respektivisht nenin 13 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se Ministria e Infrastrukturës konkursin e datës 27.06.2018 për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe Përgatitjen e Testeve për Patent Shoferë” e ka shpallur duke respektuar në plotëni autorizimin e Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 25.06.2018 dhe kriteret që janë miratuar, kështu që nuk kemi shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, rrjedhimisht Ministria e Infrastrukturës duke pasur parasysh kriteret e konkursit dhe ato të miratuara nga Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike ka zhvilluar procedurën e rekrutimit ku janë respektuar të gjitha afatet dhe procedurat e parapara me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, rrjedhimisht Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil në bazë të kriterëve të përcaktuar ka vlerësuar aplikacionet e tre (3) kandidatëve në këtë rast edhe të ankuesit dhe të njëjtit i ka përfshirë në listë të shkurtër pasi që edhe në bazë të shqyrtimit të dosjeve të tyre Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që i kanë plotësuar kushtet e konkursit dhe mbi këtë bazë është vepruar në pajtim me nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: **“Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: arsimimi dhe kualifikimi profesional dhe përvojën e punës”** dhe nenin 13 paragrafin 2 nën paragrafit 2.7 të Rregullores Nr. 05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: **“Karakteristikat e nivelit drejtues dy (2) janë: Diplomë universitare dhe së paku pesë (5) vite përvojë pune”**.



Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se meqë për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe Përgatitjen e Testeve për Patent Shoferë” të gjithë kandidatët në këtë rast edhe ankuesi kanë plotësuar kushtet e konkursit sipas nenit 27 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: **“Avancimi nga një pozitë më e ulët në pozitë më të lartë funksionale ose nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë brenda pozitës funksionale lejohet në bazë të: plotësimi të të gjitha kushteve të caktuara për atë pozitë”** dhe nenit 9 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Rregullores Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë, i cili përcakton se: **“Kriteret për avancim në karrierë të nëpunësit civil janë: plotësimi i kërkesave profesionale dhe kualifikimet e kërkuara për pozitën përkatëse”,** konsiderojmë që përzgjedhja e ankuesit në këtë pozitë është bërë në pajtim me nenin 11 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili përcakton se: **“Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve”,** nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: **“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”** dhe dispozitat e Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, rrjedhimisht Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. Prot:4440 të datës 26.04.2019 me të cilin ka anuluar të gjitha veprimet që rrjedhin nga konkursin për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe Përgatitjen e Testeve për Patent Shoferë” duke anuluar Akt Emërimit e datës 23.08.2018 e ankuesit dhe duke konstatuar që përgatitja profesionale e ankuesit nuk përputhet me përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e lartcekur, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 11, 18, 19 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, sepse Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit në Vendimin me Nr. Prot:4440 të datës 26.04.2019 nuk ka dhënë arsye të cilat përgatitje profesionale janë paraparë për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe Përgatitjen e Testeve për Patent Shoferë” dhe në bazë të cilave dispozitat janë paraparë këto kushte edhe pse në bazë të e-mailit të datës 07.08.2019 kemi kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit provë: **“Përshkrimin e detyrave të punës për këtë pozitë sipas Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Infrastrukturës nëse ka”,** mirëpo nuk kemi marr një provë të tillë, rrjedhimisht pretendimet e ankuesit janë të bazuara.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e nxjerrjes së vendimit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. Prot:6528 të datës 18.06.2019, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Marrë parasysh që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.01.2021 ka nxjerr Vendim A.nr.115/2020 me të cilin ka vendosur për ankesën e ankuesit të datës 08.04.2020, lidhur me masën disiplinore “ndërpërje e marrëdhënies së punës”, dhe e ka kthyer ankuesin në vendin e punës Koordinator për të Drejtat e Njeriut, atëherë me vendimin e datës 12.01.2021 nuk kemi pasur bazë juridike që ankuesin ta kthejmë në vendin e punës “Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe

Përgatitjen e Testeve për Patent Shofer”, sepse kjo lëndë ka qenë në procedurë gjyqësore, por meqenëse për ankesën e datës 18.07.2019 jemi të obliguar me aktgjykim të gjykatës të vendosim, atëherë Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, është i obliguar që ankuesin ta kthej në pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe Përgatitjen e Testeve për Patentë Shoferë” sipas Akt Emërimit 23.08.2018 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.262/2021

Avdy BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsora Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- *Ankuesit*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit:*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*